



VENDIM

Nr. 48 Datë 24.05.2011

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HP OSTROVICA ENERGY”
SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve; 8 pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1, gërma “g”, 5 pika 2, neneve 12, 13 dhe 14 pika “1” të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.05.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HP OSTROVICA ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “HP OSTROVICA ENERGY” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë “HP OSTROVICA ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike, për një periudhë 30 vjeçare.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.